



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

PROCESVERBAL

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERIALE TË NDRYSHME”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
44190000-8 – Materiale të ndryshme ndërtimi.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 916 620 (Një milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja “c”, si dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit kërkohet për të provuar paraprakisht përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit nga operatorët ekonomikë. Ky dokument i mundëson Autoritetit Kontraktor të kryejë verifikimin fillestar të kushteve të pjesëmarrjes në procedurë, ndërsa dokumentet provuese kërkohen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sigurimi i Ofertës kërkohet për të garantuar seriozitetin e ofertës dhe përmbushjen e detyrimeve të ofertuesit gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj. Kjo kërkesë lidhet me nevojën për të siguruar që ofertuesi të qëndrojë i angazhuar ndaj ofertës së paraqitur dhe të respektojë detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit.

Adresa: L: “Tre Heronjtë”, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: dpmop@bashkiashkoder.gov.al

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik duhet të plotësojë kërkesat për kapacitetin profesional nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe objektin e procedurës së prokurimit, e cila konsiston në furnizimin me materiale të ndryshme ndërtimi, të tilla si materiale për punime suvatimi, nivelimi, lyerjeje, shtrimi dhe mirëmbajtjeje, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se përmbushja e kapacitetit profesional mund të provohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Objekti i kontratës lidhet me furnizimin e mallrave dhe nuk përfshin kryerjen e punimeve ndërtimore apo ofrimin e shërbimeve të instalimit. Për këtë arsye, nuk është vlerësuar e nevojshme vendosja e kërkesave shtesë për kapacitetin profesional, si licenca të veçanta, autorizime profesionale apo dokumente të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me realizimin e furnizimit.

Nuk janë vendosur kërkesa shtesë për kapacitetin profesional, pasi ato nuk konsiderohen të domosdoshme për realizimin e kontratës dhe do të ishin në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe nxitjes së konkurrencës, të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare, 2023, 2024 dhe 2025, duhet të jetë jo më e ulët se 766 648 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë, që përfaqëson 40% të vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet financiare të kërkuara.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i xhiros minimale në masën 40% të vlerës së fondit limit, konkretisht 766 648 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë, është bërë duke marrë në konsideratë natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës për furnizimin me materiale të ndryshme ndërtimi.

Ky kriter synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon një kapacitet ekonomik dhe financiar të mjaftueshëm për të përballuar furnizimin, organizimin e dorëzimit dhe

përbushjen e detyrimeve kontraktore, pa vendosur një nivel xhiroje të lartë dhe të pajustificuar në raport me vlerën e kontratës.

Përcaktimi i periudhës prej 3 (tre) viteve financiare, konkretisht 2023, 2024 dhe 2025, mundëson vlerësimin e qëndrueshmërisë ekonomike të operatorit ekonomik mbi bazën e të dhënave financiare të viteve të fundit.

Mundësia që kriteri të konsiderohet i përbushur nëse operatori ekonomik arrin xhiron minimale në të paktën një nga vitet financiare të kërkuara është vendosur në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe me qëllim nxitjen e konkurrencës. Kjo shmang përjashtimin e operatorëve ekonomikë që mund të kenë pasur luhatje të aktivitetit nga njëri vit në tjetrin, por që disponojnë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e kontratës.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë përbushur detyrimet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, duke përfshirë këstet e maturuara deri në momentin e verifikimit, për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 43, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përbushjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga operatori ekonomik për vitin 2026, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të pasqyruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Përcaktimi i kësteve të maturuara të vitit 2026 është bërë në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, si dhe me afatet e pagesës të përcaktuara nga njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

Duke qenë se procedura zhvillohet gjatë vitit 2026, nuk kërkohet shlyerja paraprake e kësteve që nuk kanë arritur ende afatin ligjor të pagesës. Në këtë mënyrë, kriteri lidhet me gjendjen reale fiskale të operatorit ekonomik në momentin e verifikimit dhe nuk vendos detyrime të parakohshme.

Kërkesa është në përputhje të drejtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe garanton trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 383 324 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e katër) lekë, që përfaqëson 20% të vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 4, dhe nenit 55, pika 4, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për realizimin e furnizimeve të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 383 324 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e katër) lekë, që përfaqëson 20% të vlerës së fondit limit, është vendosur në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës.

Duke marrë në konsideratë se objekti i procedurës është furnizimi me materiale të ndryshme ndërtimi, furnizime të ngjashme do të konsiderohen furnizimet me materiale për suvatim, nivelim, lyerje, shtrim, mirëmbajtje dhe përfundim sipërfaqesh, si dhe materiale të tjera me karakteristika dhe përdorim të ngjashëm.

Ky kriter synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon përvojën e nevojshme në furnizimin e mallrave të ngjashme dhe ka aftësinë teknike e organizative për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përcaktimi i periudhës prej 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe siguron që përvoja e paraqitur nga operatori ekonomik të jetë aktuale, e verifikueshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit.

Pranimi i vërtetimeve për furnizimet e realizuara me autoritete ose ente publike dhe i faturave tatimore për furnizimet e realizuara me sektorin privat mundëson verifikimin objektiv të përvojës së mëparshme të operatorit ekonomik.

Kërkesa është në përputhje të drejtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe garanton trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët, fragmentet e katalogëve, skedat teknike (datasheet), deklaratat e performancës, deklaratat e konformitetit ose dokumentacion tjetër teknik zyrtar të prodhuesit, vetëm për mallrat për të cilat prodhuesi lëshon dokumentacion teknik dhe për të cilat ky dokumentacion është i nevojshëm për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike.

Kjo kërkesë zbatohet për mallrat e mëposhtëm:

- Llaç mbushës për suvatim;
- Fino klasike;
- Stuko patinimi pluhur;
- Çimento e bardhë, kategoria 42.5 R;

- Parket laminat;
- Bojë hidromat për ambiente të brendshme;
- Bojë akrilike për ambiente të jashtme;
- Bojë vaji për dru dhe hekur.

Dokumentacioni teknik duhet të identifikojë qartë produktin e ofertuar, duke treguar emrin e prodhuesit, emërtimin e produktit, standardin ose klasifikimin përkatës dhe, kur ekziston, modelin, kodin ose referencën e produktit.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë identifikimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së produktit të ofertuar me karakteristikat dhe parametrat teknikë përkatës të përcaktuar në specifikimet teknike, sipas llojit të mallit, duke përfshirë, sipas rastit, standardin, klasifikimin, përmasat, trashësinë, rezistencën, konsumin dhe parametrat e performancës së produktit.

Karakteristikat teknike të paraqitura në dokumentacion duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike minimale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në rast se dokumentacioni është në gjuhë të huaj, pjesët që përmbajnë karakteristikat teknike duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Dokumentacioni teknik është kërkuar vetëm për materialet që kanë karakteristika të matshme dhe standarde teknike të përcaktuara në specifikime, të cilat nuk mund të verifikohen në mënyrë të plotë vetëm nga emërtimi i produktit ose nga oferta ekonomike.

Për llaçin mbushës, finon, stukon dhe çimenton, dokumentacioni teknik nevojitet për verifikimin e standardeve, klasifikimeve, rezistencës, raportit të përzierjes, konsumit dhe kategorisë së çimentos.

Për parketin laminat dhe bojërat, dokumentacioni teknik nevojitet për verifikimin e përmasave, trashësisë, klasës së përdorimit AC4/32, bërthamës HDF dhe parametrave të performancës së bojërave, sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa nuk është shtrirë te të gjitha materialet objekt prokurimi. Për pllakën e gipsit, rrjetën me fibra xhami, profilet PVC dhe batiskopin, përputhshmëria mund të verifikohet nëpërmjet ofertës teknike, të dhënave të produktit, etiketimit dhe dokumenteve shoqëruese. Për pllakat porcelanato, verifikimi plotësohet edhe nëpërmjet mostrës së kërkuar.

Autoriteti Kontraktor nuk kërkon dokumentacion të një marke ose prodhuesi të caktuar dhe pranon produkte ekuivalente ose me karakteristika teknike më të mira, me kusht që të përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa është në përpjesëtim të drejtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e cilësisë së mallrave dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për mallrat e mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi i mallit	Njësia e mostrës	Sasia
1	Parket laminat	Panel ose copë përfaqësuese	1
2	Pllaka porcelanato	Pllakë përfaqësuese	1
3	Bojë hidromat për ambiente të brendshme	Mostër e mbyllur dhe e identifikuar	1
4	Bojë akrilike për ambiente të jashtme	Mostër e mbyllur dhe e identifikuar	1
5	Bojë vaji për dru dhe hekur	Mostër e mbyllur dhe e identifikuar	1

Mostrat duhet të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor, në adresën, datën dhe orën e përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Mostrat duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe përfaqësuese të produkteve të ofruara në ofertën ekonomike dhe në dokumentacionin teknik.

Çdo mostër duhet të jetë e identifikuar me emrin e operatorit ekonomik, emrin e prodhuesit, kur ky informacion ekziston, emërtimin e produktit, ngjyrën ose tonalitetin, kur është e aplikueshme, si dhe modelin, kodin, referencën, numrin e serisë ose lotit, kur këto të dhëna ekzistojnë.

Mosparaqitja e mostrave ose paraqitja e mostrave që nuk përputhen me specifikimet teknike, ofertën teknike ose dokumentacionin e paraqitur përbën shkak për refuzimin e ofertës.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Mostrat janë kërkuar vetëm për parketin laminat, pllakat porcelanato dhe tre llojet e bojërave, pasi këto produkte kanë karakteristika fizike dhe vizuale që mund të verifikohen drejtpërdrejt, si përmasat, sipërfaqja, ngjyra, pamja, përfundimi, ambalazhimi dhe konsistenca e dukshme.

Për bojërat dhe parketin laminat, mostrat nuk zëvendësojnë dokumentacionin teknik të kërkuar në pikën 2.3.2. Parametrat si dendësia, përmbajtja e VOC, mbetja e thatë, fuqia mbuluese, rezistenca ndaj larjes, rendimenti, koha e tharjes, klasa e përdorimit dhe bërthama HDF do të verifikohen nëpërmjet dokumentacionit teknik përkatës.

Kërkesa është kufizuar në një mostër përfaqësuese për secilin artikull dhe nuk është shtrirë të gjitha materialet objekt prokurimi. Për këtë arsye, ajo është në përpjesëtim të drejtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk favorizon ndonjë markë ose prodhues të caktuar dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentin “**Ofertë Teknike**”, sipas modelit të përcaktuar më poshtë në këtë pikë të Dokumenteve të Tenderit.

Dokumenti “**Ofertë Teknike**” duhet të përmbajë, për secilin produkt të ofertuar, të paktën të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i produktit	Emërtimi i prodhuesit	Emërtimi i katalogut, skedës teknike ose dokumentit përkatës	Referenca në dokumentacion	Shënime
-----	----------------------	-----------------------	--	----------------------------	---------

Operatori ekonomik duhet të respektojë këto kërkesa:

- Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të jetë sipas listës së mallrave të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7;
- Në kolonën **“Emërtimi i prodhuesit”** duhet të shënohet prodhuesi i produktit, kur ky informacion ekziston;
- Në kolonën **“Emërtimi i katalogut, skedës teknike ose dokumentit përkatës”** duhet të shënohet dokumenti mbi të cilin mbështetet oferta, sipas kërkesave të pikës 2.3.2;
- Në kolonën **“Referenca në dokumentacion”** duhet të shënohet kodi i produktit, numri i faqes, seksioni përkatës ose çdo referencë tjetër që mundëson verifikimin e produktit;
- Për materialet për të cilat nuk kërkohet katalog ose skedë teknike sipas pikës 2.3.2, operatori ekonomik mund të shënojë **“Nuk aplikohet”**, duke dhënë në kolonën **“Shënime”** të dhënat identifikuese të produktit;
- Në kolonën **“Shënime”**, operatori ekonomik mund të japë informacion shtesë ose sqarime mbi produktet e ofruara.

Të dhënat e pasqyruara në dokumentin **“Ofertë Teknike”** duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike, katalogët, skedat teknike, dokumentacionin tjetër të paraqitur dhe mostrat e dorëzuara për parketin laminat, pllakat porcelanato dhe bojërat e përcaktuara në pikën 2.3.3.

Mosparaqitja e dokumentit **“Ofertë Teknike”**, ose mosplotësimi i tij në atë masë që pamundëson identifikimin e produktit të ofruar dhe verifikimin e përputhshmërisë së tij me specifikimet teknike, përbën shkak për refuzimin e ofertës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentit **“Ofertë Teknike”** është vendosur me qëllim krijimin e një lidhjeje të qartë dhe të verifikueshme ndërmjet produkteve të ofruara, specifikimeve teknike dhe dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik.

Plotësimi i këtij dokumenti i mundëson Autoritetit Kontraktor identifikimin e saktë të produktit, prodhuesit, katalogut ose dokumentit teknik përkatës, si dhe të referencës konkrete ku gjenden karakteristikat e produktit. Kjo ndihmon në kryerjen e një vlerësimi objektiv, transparent dhe të njëtrajtshëm të ofertave.

Për produktet për të cilat kërkohet dokumentacion teknik sipas pikës 2.3.2, referenca në katalog, skedë teknike ose dokument tjetër zyrtar mundëson verifikimin e drejtpërdrejtë të përputhshmërisë me specifikimet teknike. Për materialet për të cilat nuk kërkohet katalog ose skedë teknike, përdorimi i shënimit **“Nuk aplikohet”** shmang vendosjen e kërkesave të panevojshme, duke ruajtur detyrimin për identifikimin e qartë të produktit të ofruar.

Kjo kërkesë nuk vendos detyrim për paraqitjen e dokumentacionit teknik shtesë përtej atij të përcaktuar në pikën 2.3.2, por shërben për sistemimin dhe referimin e informacionit të paraqitur nga operatori ekonomik.

Përputhshmëria e të dhënave të Ofertës Teknike me dokumentacionin e paraqitur dhe me mostrat e dorëzuara për parketin laminat, pllakat porcelanato dhe bojërat, krijon mundësinë e verifikimit të njëtrajtshëm të ofertës dhe shmang paqartësitë gjatë procesit të vlerësimit.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e procedurës, është në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk favorizon ndonjë markë, prodhues, origjinë apo operator ekonomik të caktuar. Për rrjedhojë, ajo respekton parimet e proporcionalitetit, konkurrencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përgatitur duke marrë në konsideratë nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për furnizimin me materiale të ndryshme ndërtimi dhe materiale për punime mirëmbajtjeje, të cilat do të përdoren për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve publike dhe të hapësirave në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër.

Karakteristikat teknike të përcaktuara për secilin artikull janë hartuar mbi bazën e funksionit që do të kryejë materiali, kushteve të përdorimit, përmasave, përbërjes, qëndrueshmërisë, sigurisë, cilësisë dhe performancës së kërkuar.

Specifikimet përfshijnë materiale të ndryshme ndërtimi dhe përfundimi, si pllaka gipsi, rrjetë fiberglass, llaç mbushës, fino, stuko, çimento e bardhë, profile PVC, parket laminat, batiskop parketi, pllaka porcelanato dhe bojëra për ambiente të brendshme, ambiente të jashtme, dru dhe hekur.

Për materialet e përcaktuara në pikën 2.3.2, për të cilat prodhuesi disponon dokumentacion teknik dhe për të cilat ky dokumentacion është i nevojshëm për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike, kërkohet paraqitja e katalogëve, skedave teknike, deklaratave të performancës, deklaratave të konformitetit, sipas rastit, ose dokumentacionit tjetër teknik zyrtar të përshtatshëm.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni teknik do të verifikohen, sipas rastit, standardi, klasifikimi, përmasat, trashësia, rezistenca, konsumi, raporti i përzierjes, rendimenti, koha e tharjes, përmbajtja e VOC, rezistenca ndaj larjes dhe karakteristika të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike.

Për parketin laminat, pllakat porcelanato dhe tre llojet e bojërave është parashikuar edhe paraqitja e mostrave, pasi këto produkte kanë karakteristika fizike dhe vizuale që mund të verifikohen drejtpërdrejt, si përmasat, trashësia, sipërfaqja, ngjyra ose tonaliteti, pamja, përfundimi dhe identifikimi i produktit të ofruar.

Kërkesa për mostra është kufizuar vetëm në këto produkte dhe është vendosur në përpjesëtim të drejtë me objektin, natyrën dhe vlerën e procedurës së prokurimit. Mostrat do të përdoren për verifikimin fizik të produktit, ndërsa parametrat teknikë dhe të performancës do të verifikohen nëpërmjet dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik.

Adresa: L: “Tre Heronjtë”, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: dpmop@bashkiashkoder.gov.al

Për garantimin e cilësisë së furnizimit, mallrat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të përshtatshme për përdorimin e kërkuar dhe të dorëzohen në ambalazh të përshtatshëm për ruajtjen dhe transportin e tyre. Kur është e aplikueshme, mallrat duhet të shoqërohen me të dhënat e prodhuesit, lotit ose serisë, datës së prodhimit dhe afatit të përdorimit.

Gjatë lëvrimit dhe marrjes në dorëzim, Autoriteti Kontraktor do të verifikojë përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike, ofertën teknike, dokumentacionin e paraqitur dhe, sipas rastit, mostrat e paraqitura dhe të pranuara gjatë vlerësimit.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të sigurojnë konkurrencë të hapur, trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë, pa favorizuar një prodhues, markë, origjinë ose proces të caktuar prodhimi. Çdo referencë ndaj një standardi, klasifikimi ose zgjidhjeje teknike të caktuar do të kuptohet e shoqëruar me shprehjen **“ose ekuivalente”**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor nuk ka vendosur kërkesa që lidhen me një prodhues ose markë të caktuar dhe nuk ka kërkuar certifikim të përgjithshëm ISO nga operatori ekonomik, pasi cilësia e mallrave konkretë do të verifikohet nëpërmjet parametrave teknikë minimalë, dokumentacionit teknik, ofertës teknike, mostrave dhe kontrollit gjatë lëvrimit.

Përcaktimi i specifikimeve teknike është bërë në bazë të nevojave reale të Autoritetit Kontraktor dhe në funksion të sigurimit të materialeve cilësore, funksionale, të sigurta dhe të përshtatshme për punimet e mirëmbajtjes, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, konkurrencës, transparencës dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.